VENDIM
Nr.947, datë 2.7.2008

PËR VENDOSJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME ISHUJT SOLOMON

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me ishujt Solomon.
2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha